REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Nr 5103/1 prot

Lushnje 17/06/2025

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. 51 DATË 17/06/2025**

**PËR MIRATIMIN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE PRIVATE QË PREKEN NGA PROJEKTI " SISTEMIMI I SHESHIT DHE TREGUT FRUTA PERIME NË LAGJJEN , 'SKËNDER LOBOHOVA , RRUGA PAVARËSIA ".**

Këshilli i Bashkisë Lushnje, në mbledhjen e datës___/___/2025,pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni i Shpronësimeve në Bashkinë Lushnje, i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 9 pika 1.2 germa "a"," b", neni 23 pika a të ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit Nr.8561 date 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik, të ndryshuar neni 7, neni 8 dhe neni 9; VKM nr.127,datë 23.3.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik; VKM nr.138,datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", **JU** :

**PROPOZOJMË:**

Adresa:Lagjia "Kongresi " Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

1. Të miratohet shpronësimi për interes publik të pasurisë private me nr.7/3 e ndodhur në ZK 8572 që preket nga projekti "Sistemimi i sheshit dhe tregut fruta perimeve në lagjjen 'Skënder Libohova , rruga Pavarësia" në vlerën totale 1,504,272 lekë.
2. Të miratohet shpronësimi për interes publik të pasurisë private me nr.7/8 e ndodhur në ZK 8572 që preket nga projekti "Sistemimi i sheshit dhe tregut fruta perimeve në lagjjen 'Skënder Libohova , rruga Pavarësia" në vlerën 2,417,040 lekë.
3. Të miratohet shpronësimi për interes publik të pasurisë private me nr.7/196 e ndodhur në ZK 8572 që preket nga projekti "Sistemimi i sheshit dhe tregut fruta perimeve në lagjjen 'Skënder Libohova , rruga Pavarësia" në vlerën 2,327,520 lekë.
4. Të miratohet shpronësimi për interes publik të pasurisë private me nr.7/198 e ndodhur në ZK 8572 që preket nga projekti "Sistemimi i sheshit dhe tregut fruta perimeve në lagjjen 'Skënder Libohova , rruga Pavarësia" në vlerën 707,208 lekë.
5. Ngarkohet Komisioni i shpronësimeve për zbatimin dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

**DREJTORIA JURIDIKE**

**Bedri Hida**

**DREJTORIA PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

**Mimoza Haxhiu**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Eriselda Sefa**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com